

NJOFTIM-SHPREHJE INTERESI

FTESË PËR APLIKIM PËR DISENJIMIN E LOGOS SË BQK-së

Data: 22.07.2019

Nr. i Prokurimit: *BQK 19 035 331*

LËNDA DHE PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: DISENJIMI I LOGOS SË BQK-së.
Lloji i prokurimit: <i>Pune</i>
Vendi kryesor i realizimit: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës fton të gjithë të interesuarit që të bëhen pjesë e garës për disenjimin e Logos së BQK-së.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga komisioni i themeluar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Personi, propozimi i të cilit zgjidhet si logoja zyrtare e Bankes Qendrore te Kosoves, do të shpërblehet me shumën prej 5,000.00 Euro (Pesëmijë).

Kriteret lidhur me disejnimin e logos së BQK-së janë:

1. Logoja duhet të jetë unike dhe të shprehë funksionin, misionin, vizionin dhe vlerat e BQK-së.
2. Logoja duhet të ketë një pasqyrim artistik të veprimitarisë së BQK-së.
3. Të përçoj mesazhin e qartë të rolit dhe rëndësisë së BQK-së për vendin.
4. Të jetë e dallueshme, që i reziston kohës dhe e lehtë për t'u kuptuar e mbajtur mend.
5. Të përmbajë elemente historike të Kosovës.
6. Të përmbajë elemente të rrugës së integritimeve evropiane të vendit.
7. Fonti i shkronjave duhet të jetë i veçantë nga fontet ekzistuese.
8. Ngjyrat e logos duhet të jenë unike dhe për secilën duhet të ketë shpjegim.
9. Logoja duhet të jetë e kualitetit të lartë me qëllim të përdorimit të saj në madhësi të ndryshme dhe pa prishje të rezolucionit.
10. Logoja duhet të jetë e mundshme për konvertim në të gjitha versionet (JPG, PNG, TIF, Vector, etj).
11. Logoja duhet të jetë e mundshme për përdorim në dokumente fizike, paraqitje elektronike (web të BQK, në ikonën e webit (favicon), në rrjetet sociale etj), në sfonde të bardha dhe të errëta.
12. Të jetë e përshtatshme për t'u përdorur në dimensione të ndryshme (si për shembull, në kartëvizita dhe billboardet)

13. Autori duhet të respektojë dhe të mbaj përgjegjësi bazuar në Ligjin Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/1-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Konkurimi:

Propozimet për logon e BQK-së duhet të dorëzohen në pliko të mbyllur, e cila brenda duhet të përmbajë:

- Punimet e printuara dhe në CD, së bashku me manualin e shpjegimeve të përmbajtjes dhe përdorimit;
- Punimet duhet të përmbajnë vetëm një kod/shifër identifikuese dhe jo të dhënat personale të autorit;
- Të dhënat personale të autorit duhet të futen në një zarf tjetër të vogël, i cili hapet vetëm pas përzgjedhjes së logos;
- Punimet e printuara dhe në CD duhet të vendosen në një zarf, i cili duhet të përmbajë edhe zarfin e mbyllur me shënimet personale të autorit.
- Një autor mund të aplikojë me më shumë se një ide;
- Nëse një autor aplikon me më shumë se një ide, aplikimi bëhet me pliko të veçantë dhe kod/shifër të veçantë;

Të drejtat e autorit për propozimet e përzgjedhura barten nga propozuesi te BQK-ja.

Kushtet për aplikim me propozime:

Të drejtë aplikimi me propozime për logon kanë personat fizik dhe juridik.

Në rast të aplikimit si Operator Ekonomik/person juridik, atëherë operatori ekonomik/personi juridik duhet të dorëzojë regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik;

Në mënyrë që të dëshmohet se është i përshtatshëm, personi fizik duhet të dorëzojë një dokument identifikimi.

Kushtet për dorëzimin dhe informatat tjera;

Punimet duhen të jenë në pliko të mbyllura dhe të kenë shifrën “Disejtimi i logos së BQK-së”

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve: *21.08.2019*

Afati për sqarime shtesë: *14.08.2019*

ADRESA:

Rr. Garibaldi nr. 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i Prokurimit	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763